

RELACION TEKNIK

Objekti: “Rehabilitimi i tombino/tubosider në aksin rrugor Qafa e Buallit – Fillimi i rrugës së Arbërit”

Pas disa kërkesave të ardhura nga Bashkia Bulqizë në Autoritetin Rrugor Shqiptar u ngrit grupi i punës për verifikimin e situatës në vend dhe hartimin e dokumentacionit teknik për zgjidhjen e problematikës.

Pas verifikimit të gjendjes u konstatua se tombino me konstruksion tubosider e vendosur në trupin e rrugës, në segmentin rrugor Qafë Bualli – dalje lindore e Qytetit të Bulqizës (pjesë e rrugës së Arbërit) ishte jashtë pune duke krijuar një disnivel të konsiderueshëm të shtratis të kanalit me shtratin e tombinos “tubosider”.



Rruga në afërsi të tombinos me konstrukcion “tubosider” nuk ka shfaqur problematika të shtresave asfaltike por as çedime apo ulje të trupit të rrugës. Dalja jashtë pune e kësaj tombino ka ardhur si rezultat i uljeve gjeologjike të të gjithë fushëgropës së Bulqizës. Ulja e krijuar në vite ka prekur edhe rrugën në zbritje të segmentit nga Qafa e Buallit deri në nyjen në hyrje të Qytetit të Ri të Bulqizës, ku janë shfaqur çedime të trupit të rrugës. Kjo fushëgropë e ka krijuar pikën më të ulët të saj në afërsi të Qytetit të vjetër të Bulqizës duke shërbyer edhe si ujëmbledhës natyral. Ky ujëmbledhës shkarkon ujë në drejtimin lindor nëpërmjet kanalit kullues të quajtur Zalli i Bulqizës. Pikërisht ulja e fushëgropës bën që të ulet edhe shtrati i këtij kanali i cili nuk arrin të kalojë ujë nëpërmjet tombinos me konstrukcion “tubosider”.



Për kalimin e ujit në mot me pak reshje, shërben një tombino betoni e ndërtuar si ndihmëse gjatë kohës së ndërtimit të rrugës. Kjo tombino betoni është me diametër të pamjaftueshëm për përballimin e prurjeve gjatë motit me reshje të shumta. Pikërisht mosfunksionimi i tombinos “tubosider” sjell rritjen e nivelit të ujëmbledhësit me pasojë përmytjen e banesave dhe bizneseve të qytetit të vjetër të Bulqizës.

Për zgjidhjen teknike të këtij problemi nevojitet ulja e të tombinos deri në kuotën e tabanit të kanalit. Ndërhyrja konsiston në çmontimin e portaleve prej gabioni të hyrjes dhe daljes së tombinos, prerjen dhe heqjen e shtresave asfaltike, gërmimin nenshtresave rrugore deri në zbulimin e tombinos tubosider.



Më pas do të ngrihet dhe spostohet tubi prej metali i tombinos, për tu ripërdorur më pas. Do të bëhet gërmimi i tabanit i cili do të thellohet deri në kuotën e kërkuar. Më pas do të rivendoset tombino duke respektuar të gjitha kriteret teknike të vendosjes së shtresave mbështjellëse. Paralelisht me to do të riformatohen dhe rindërtohen portalet prej gabioni të hyrjes dhe daljes së tombinos. Më pas do të kompletohen nënshtresat rrugore dhe shtresat asfaltike si dhe punimet e tjera plotësuese.

Gjatë realizimit të punimeve qarkullimi i mjeteve do të devijohet në rrugën e vjetër që përshkon Qytetin e vjetër të Bulqizës.



